



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.562/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Kundërshtimi i vendimit të KVO lidhur me vlerësimin në pikë të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik të bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k.& “Drini-1” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65268-07-13-2020, me objekt Loti V “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Rëshen (U.Fanit)-Shpal, Shpal-Q. Bene-K.Hadroj, Shpal-Ura e Repsit”, me fond limit 219.866.693 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar”.

Ankimues:

BOE “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini-1” sh.p.k.
Nj.A. Fan, Ndërtesa me numër pasurie 40, Zona Kadastrale1717, Mirditë/ Kutia Postare 245/1 Tiranë/
Rruga “Imer Puka”, Blloku Nr. 03, Banesa Nr. 40, Kati I-rë, Pasuria Nr. 1150, Z.K 3069, Pukë

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga “Sami Frashëri”, nr. 33, Tiranë

Subjekte të interesuara:

BOE “ALB SHPERSA” shpk & “MELA” sh.p.k & “Xhast” shpk

Rruga: “Maliq Mucco” Ndërtesa 6 Hyrja 14 Tiranë

“Jubica” sh.p.k.

Rruga: “Luigj Gurakuqi” Kuklejt, nr.108, Shkodër

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65268-07-13-2020, me objekt Loti V “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Rëshen (U.Fanit)-Shpal, Shpal-Q. Bene-K.Hadroj, Shpal-Ura e Repsit”, me fond limit 219.866.693 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar”.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr8631/1 datë 10.11.2020 si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 05.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit). Në këtë fazë kanë marrë pjesë operatorët si më poshtë.

- | | |
|---|--------------|
| - BOE ALB SHPERSA& MELA sh.p.k. | kualifikuar |
| - OE JUBICA sh.p.k. | kualifikuar |
| - OE KTHELLA sh.p.k. | kualifikuar |
| - BOE AEK MUNELLA sh.p.k. & DRINI-1 sh.p.k. | kualifikuar |
| - 6D –PLAN | skualifikuar |

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se pas mbylljes së fazës së parë dhe në përfundim të afateve të ankimit autoriteti kontraktor më datë 03.09.2020 me shkresën nr. 4758/13prot., nëpërmjet sistemit elektronik ka drejtuar tek operatorët ekonomikë ftesën për ofertë. Data e përcaktuar për hapjen e ofertave është data 18.09.2020 ora 13:30. Operatorët që i janë përgjigjur ftesës për dorëzimin e ofertës ekonomike janë:

Nr.	Operatori ekonomik	Cmimi total i ofertës në lekë pa përfshire vlerën TVSH-së Para korigjimit	Pas Korigjimit
1.	BOE ALB SHPERSA & MELA	150.000.000	

	sh.p.k.		
2.	JUBICA sh.p.k.	175.000.000	
3.	KTHELLA sh.p.k.	135.536.616	
4.	AEK MUNELLA sh.p.k. & DRINI-1 sh.p.k.	197.273.824	

Në datën 18.09.2020 është zhvilluar faza e dytë e procedurës së prokurimit për dorëzimin e propozime teknike dhe ekonomike.

II.4. Në datën 12.10.2020 KVO-ja përfundoi vlerësimin në pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. BOE ALB SHPERSA& MELA sh.p.k&Xhast shpk

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin	Pikët përvoja në punë e kompanisë	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total Cilësi $\sum 1+2+3$
1	150.000.000	55	14	17	86
2	150.000.000	54	14	17	85
3	150.000.000	54	14	17	85

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 85.33 pikë.(bashkëlidhur argumentimi i pikëve nga anëtarët e KVO-së

2. OE JUBICA sh.p.k.

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin	Pikët përvoja në punë e kompanisë	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total Cilësi $\sum 1+2+3$
1	175.000.000	47	18	20	85
2	175.000.000	46	18	20	84
3	175.000.000	46	18	20	84

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 84.33 pikë.(bashkëlidhur argumentimi i pikëve nga anëtarët e KVO-së

3. OE KTHELLA sh.p.k.

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin	Pikët përvoja në punë e kompanisë	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total Cilësi $\sum 1+2+3$
------------------	------------------	------------------	-----------------------------------	--	---------------------------

			kompanisë		
1	135.536.616	60	13	13	86
2	135.536.616	60	13	13	86
3	135.536.616	60	13	13	86

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 86 pikë.(bashkëlidhur argumentimi i pikëve nga anëtarët e KVO-së.

4. BOE AEK MUNELLA sh.p.k. & DRINI-1 sh.p.k.

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin	Pikët përvoja në punë e kompanisë	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total Cilësi $\sum 1+2+3$
1	197.273.824	42	20	17	79
2	197.273.824	41	20	17	78
3	197.273.824	41	20	17	78

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 78.33 pikë.(bashkëlidhur argumentimi i pikëve nga anëtarët e KVO-së.

Referuar informacionit të autoritetit rezulton se operatori ekonomik Kthella shpk është skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se: Operatori ekonomik Kthella shpk duhet të refuzohet me arsyetimin se oferta përmban risk të lartë për mospërmbushje të detyrimeve kontraktore.

Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikë
1	Alb Shpresa &Mela	85,33
2	Jubica	84.33
3	AEK Munella&Drini	78.33

II.5. Në datën 23.10.2020 KVO-ja përfundoi rivlerësimin në pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. BOE ALB SHPERSA& MELA sh.p.k.

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin	Pikët përvoja në punë e kompanisë	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total Cilësi $\sum 1+2+3$
1	150.000.000	55	14	17	86

2	150.000.000	54	14	17	85
3	150.000.000	54	14	17	85

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 85.33 pikë.(bashkëlidhur argumentimi i pikëve nga anëtarët e KVO-së

2. OE JUBICA sh.p.k.

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin	Pikët përvoja në punë e kompanisë	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total Cilësi $\sum 1+2+3$
1	175.000.000	47	18	20	85
2	175.000.000	46	18	20	84
3	175.000.000	46	18	20	84

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 84.33 pikë.(bashkëlidhur argumentimi i pikëve nga anëtarët e KVO-së

3. BOE AEK MUNELLA sh.p.k. & DRINI-1 sh.p.k.

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin	Pikët përvoja në punë e kompanisë	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total Cilësi $\sum 1+2+3$
1	197.273.824	42	20	20	82
2	197.273.824	41	20	20	81
3	197.273.824	41	20	20	81

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 81.33. pikë.

II.5. Në datën 19.10.2020, BOE “AEK Munella” sh.p.k.& “Drini-1” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, në mënyrë të përmbledhur me pretendimet si më poshtë:

Kemi dyshime të arsyeshme se vlerësimi i operatorëve Alb Shpresa, Jubica, Kthella nuk është bere ne perputhje me VKM madje me aq sa njofim kapacitetet e tyre ato nuk kane kontrata te ngjashme per te marre kete pikezim. Rrjedhirsht metodologjia e perdorur prej tyre nuk ploteson as minimumin e kerkesave te paraqitura nga Autoriteti Kontraktore.

Mendojem se vleresimi i Komisionit te Vlersimit te Ofertave eshte i pa drejte dhe i pa bazuar ne ligj per arsyeje se:

Referiojmë LPP-NË [...] Ligjin nr. 9800 datë 10.09.2007

Ligjin nr. 9855 datë 26.12.2007 ligjin 10170 datë 22.10.2009 ligjin nr. 10309 datë 22.07.2010 ligjin 22/2012 ligjin 131/2012 ligjin 182/2014 dhe ligjin 47/2017 neni 55 pika b oferta fituese duhet të jetë[...], mendojmë se oferta jonë është më e favorshme dhe meritojmë pikët maksimale përse ipërket kriterëve të vlerësimit tek përvoja e punës dhe cilësia për arsye se BOE ka një punë të pasur përse i përket veprimtarisë së tyre në fushën e mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të rrugëve dhe një staf të kualifikuar duke u paraqitur më pshtë listën e përvojës së punës së kompanive:

Shoqeria AEK Munella Shpk ka pasur keto kontrata ne fushen e mirembatjes:

1. "Mirembatja rutine dhe dimerore rruga Rreshen- Qaf Bene" Kontrata Nr 231 date 18.07.2011 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoder me vleren 51.814.405 Leke me Tvsh. Afati i kontrate 3 vite.
2. "Mirembatja rutine rruga degezimi Superstrada - Balldre - Kukel - Rranxa, 18.5 km" Kontrata Nr.39/6 date 11.07.2013 lidhur me Drejtoria Rajonale Verior. Shkoder me vleren 13.806.120 leke me Tvsh. Afati i kontrates 2 vite
3. "Mirembatja Rutine e Dimerore Segmenti Rrugore Degezimi i autostrades Thumane - Milot, fundi i superstrades 26.7 km (Emergjence)" Kontrata Nr.33/7 date 02.02.2015 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoder me vleren 9.956.520 leke me Tvsh. Afati i kontrates 6 muaj.
4. "Mirembatje rutine e dimerore rruga Milot - Skuraj - Rreshen, 23.6 km" Kontrata Nr.46/6 date 24.06.2013 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoder me vleren 32.778.720 leke me Tvsh. Afati i kontrates 2 vjet.
5. Mirembatje rutine e Rruges se Kombit ,segmenti rrugore, Degezohet me autostraden Thumane - Milot ,hyrja e Tunelit Thirre 73.15 km (emergjence) Kontrata Nr.8/10 date 14.07.2016 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoder me vleren 36.762.266 leke me Tvsh. Afati i kontrates 4 muaj.
6. Mirembatje rutine e Rruges se Kombit ,segmenti rrugore, Degezohet me autostraden Thumane - Milot ,hyrja e Tunelit Thirre 73.15 km (emergjence) Kontrata Nr.11/10 date 01.12.2016 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkodër me vleren 56.256.672 lekë me tvsh afati i kontratës 6 muaj.
7. "Mirembatja rutine e dimerore Rrugua Ura e Matit - Rreshen - Urake, Shaple - Ura e repsit 46 km" Kontrata Nr.14/10 date 14.12.2015 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoder me vleren 114.470811 leke me Tvsh. Afati i kontrates 2 vite .
8. "Mirembatja rutine e dimerore Rrugua Ura e Matit - Rreshen - Urake , Shaple - Ura e repsit 46 km" (Shtese Kontrate 20%) Kontrata Nr.18/5 date 14.12.2017 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoder me vleren 22.421.524 leke me Tvsh. Afati i kontrates 5 muaj .
9. "Mirembatje me performance ,kontrata nr3, km 87.5" Kontrata Nr.213 date 27.05.2015 lidhur me Drejtoria Rajonale Qendrore Tirane me vleren 42.327.329 leke me Tvsh. Afati i kontrates 2 vite.
10. "Mirembatja rutine e dimerore segmenti rrugore K/dajt - Bize -0/Priske-Shengjergj (76 Km)" Kontrata Nr.159 date 18.12.2018 lidhur me Drejtoria

Rajonale Qendrore Tirane me vleren 8.012.678 leke me Tvsh. Afati i kontrates 5 muaj .

Shoqeria DRINI-1 Shpk ka pasur keto kontrata ne fushen e mirembatjes:

1. "Pastrim Bore dhe Inerte nga rruga (emergjence)" Kontrata Nr 6/3 date 21.02.2011 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoderme vleren 3.998.700 Leke me Tvsh. Afati i kontrate 1 muaj.
2. "Mirembatja rutine e dimerore Q.Mali - Fierze" Kontrata Nr.7/5 date 21.02.2011 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoder me vleren 95.211.552 leke me Tvsh. Afati i kontrates 3 vite.
3. "Mirembatja Rutine e Dimerore Q.Lac - Koman 32.4 km" Kontrata Nr.54/9 date 23.12.2014 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoder me vleren 40.004.696 leke me Tvsh. Afati i kontrates 2 vite.
4. "Mirembatje rutine e dimerore rruga K/Hadroj- Qaf Ben 27 km" Kontrata Nr.47/6 date 23.06.2014 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoder me vleren 36.202.440 leke me Tvsh. Afati i kontrates 2 vjet.
5. Mirembatje rutine e dimorore Lac - Vau I Dejes - Fushe Arrës 60.1 km Kontrata Nr.29/10 date 25.01.2016 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkodër me vlerën 59.793.120 leke me Tvsh. Afati i kontrates 1 vite.
6. "Rehabilitimi i shembjeve ne segmentin Lac -Vau i Dejes - Fushe Arres (emergjence) Kontrata Nr.12/10 date 30.12.2016 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoder me vleren 32.227.233 !eke me Tvsh. Afati i kontrates 1 vite.
7. "Mirembatje rutine dhe dimerore me performance e akseve rrugore K/Hadroj - Qafe Bene - ,27 km+ Rreshen - Qaf Bene , gjithesej 54.62 km" Kontrata Nr.4549/5 date 23.12.2016 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkoder me vleren 32.227.233 !eke me Tvsh. Afati i kontrates 2 vite.

BOE "AEK Munella" Shpk & "DRINI-1" Shpk ne mbeshtetje te LPP Neni 55 Pika b "Oferta fituese duhet te jete : oferta ekonomiksht me e favorshme, bazuar ne kriteret e ndryshme te lidhura me objektin e kontrates qe prokurohet, si: cilesia, cmimi, cilesite teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmeria ekonomike, sherbimi pas shitjes dhe asistenca teknike-data-dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit me kusht që këto kritere të jene objektive dhe jodiskriminuese, B.O me ane te deklarave ka inofnuar se ka si adrese kryesore te kantierit dhe veprimtarise se tyre ne afersit te objekti te cilit prokurorohet , makinerite qe ajo ka ne pronesi ndodhen ne afersi te objektit dhe do jene te angazhuara vetem per kete objekt dhe nuk jane te angazhuara ne objekte te tjera, stafi inxhinierik dhe teknik jane mese profesioanl, eshte paraqitur gjithashtu grafiku ipunimeve si dhe metodologjie me te mire per te kryer nje pune sa me efikase.

Tek metodologjia e perdorur eshte e nderthurur edhe grafiku i punimve. Edhe nje here ju paraqesim metodologjine e perdorur nga ana jone si me poshte:

1. Para fillimit te punimeve, ekipi i zbatimit te projektimit do te organizohet per te pregatitur dhe zhvilluar Studimin e Gjendjes Fillestare dhe Raportin e Gjendjes Fillestare. Keto masa jane te perfshira ne sa me poshte vijon:

Pregatitja e punimeve do te kryhet ne perputhje me kushtet kontraktuale, specifikimet teknike, projektin dhe dokumentacionet plotesuese.

Pregatitja e punimeve dote behet bazuar ne Planin i cili perfshin: Studim te gjendjes fillestare

Raporti i gjendjes fillestare

Projektin perfundimtar te hollesishen duke perfshire te gjithë llogaritjet e nevojshme ne perputhje me Specifikimet Teknike.

Pasi projekti perfundimtar te jete finalizuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor, do te filloje pregatitja per punimet ndertimore duke ndjekur hapat e meposhtem:

Planifikimi i listes se materialeve

Planifikimi i listes se pajisjeve

Planifikimi i listes se mjeteve

Tabelat informuese per kantierin

Punimet e kantierit

2. Nese kontrata e parashikon, informacioni i grumbulluar nga studimet ne terren do te perdoret per te projektuar dhe llogaritur masat qe do te merren. Ekipi i projektimit do te analizoje informacionin dhe dote pregatise projektin e zbatimit duke perdorur programe profesionale sipas kerkesave teknike (SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TE MIREMBATJES).

3. Keto punime fillojne me pastrimin e mbetjeve dhe mbeturinave, epastrimi dhe grumbullimi i bimesise, pastrimi dhe ristrukturimi i kanaleve kullues ekzistues, skarifikimi dhe ristrukturimi i siperfaqes ekzistuese, germimet e nevojeshme per kanalet dhe trupin e rruges.

Brenda kufijeve te pastrimit dhe germlimit te percaktuar ne vizatime, siperfaqet duhet te jene të mirëmbajtura dhe të pastra nga bimësia mjetet ndërtimore etj. Në këtë kategori pune perfshihen:

- *Ristrukturim i skarpatave*
- *Rindertim i argjinaturave (nese jane present)*
- *Riparim i shpatullave*

- *Pastrim i tombinove dhe strukturave te tjera kulluese*
- *Pastrimi nga bimesia*
- *Pastrimi i mbeturinave dhe mbetjeve ndertimore*

Ristrukturimi i skarpatave do te behet duke perdorur eskavator me kove ose fadrome e cila do te prese dhe do ti jape nje forme te rregullt dhe te rrafshet, Procesi i ndertimit dote filloje duke rrethuar zonen e ndertimit me sinalistiken e pershtateshme te sigurise dhe rrethimet perkatese. Asnje proces pune nuk do te filloje pa u siguruar me pare leja e fillimit nga ekipi i Sigurimit Teknik. Masat e sigurise dhe devijimit te trafikut do te ndermerren sipas manualit "Udhetime operative per menaxhimin dhe mirembajtjen rrugore".

Rindertimi i argjinatures dhe riparimi i shpatullave dote kryhen duke perhapur materialin adekuat te gurit te grimcuar sipas Specifikimit dhe vizatimeve. Ky material do te perhapet me dore nese zona eshte e vogel dhe nuk eshte e mundur te arrihet nga germuesit ose ngarkuesit. Ne kete rast perhapja e materialit agregat do te kryhet me dore duke perdorur lopate dhe kornpaktesuar nga kompaktore te deres se vogel, Nese hapesira mund te arrihet nga germuesit dhe roletat, punimet e ndertimit do te kryhen prej tyre duke perdorur ekskavator per perhapjen e materialit dhe rulit te lehte per te kompaktuar zonen deri ne dendesine e kerkuar te specifikuar ne Specifikimet Teknike.

Rindertimi i argjinatures dhe riparimi i shpatullave dote kryhen duke erhapur materialin adekuat te gurit te grimcuar sipas Specifikimeve teknike dhe vizatimeve të projektit. Ky material dot e perhapet me dore nese zona eshte e vogel dhe nuk eshte e mundur te arrihet nga makinerite e germimit, Ne kete rast perhapja e materialit agregat do te kryhet me dore duke perdorur lopate dhe kompaktues me kompaktor dore. Nese hapesira mund te arrihet nga makinerite germuese dhe cilindrato, punimet e ndertimit do te kryhen prej tyre duke perdorur ekskavator per perhapjen e materialit dhe rulim te lehte per te kompaktuar zonen deri sate arrije nivelin e kompaktuesimit te specifikuar ne Specifikimet Teknike.

Pastrimi i strukturave te kullimit do te jete nje veprim tjeter qe do te ndermerret kryesisht ne tombino. Ne pergjithesi, strukturat e kullimit keshillohen te mirembahen duke u pastruar dhe ky veprim dote kryhet duke perdorur nje makine te posacme e cila dote dergoje uje me presion ne hyrje te tombinos ose duke i pastruar ato manualisht me dorë ose lopate,

Pastrimi i rruges nga bimesia do te behet duke perdorur makine prerese te motorizuar ose duke i prerë me dorë në ato zona të rrugës ku aksesimi me makineri është i pamundur.

4. Punimet e kullimit konsistojne ne veprat e meposhtme:

- *Krijimi i kanaleve te reja tokesore*

- *Ndertimi i kanaleve te reja te betonit*
- *Riparimi dhe ristrukturimi i kanaleve ekzistuese te tokes*
- *Riparimi i kanaleve ekzistuese te betonit*

Ndertimi i kanaleve te reja tokesore do te kryhet ne perputhje me dispozitat e kontrates, modelit teknik dhe direktivave te dhena nga perfaqesuesi i Konsulentit. Punimet e ndertimit do te kryhen nga germuesit ne zonat ku eshte e mundur te arrihen prej tyre ose me dore, nese terreni nuk lejon germime nga germuesit. Materiali i germuar do te transportohet me kamion ne zonat e percaktuara te depozitimit.

5. Kompaktesimi dhe pregatitja e tokes per Punimet e Shtresave Rrugore

Si fillim, para ndertimit te shtresave rrugore, do te procedojme me kompaktesimin e shtreses se tabanit. Bazamenti pas kompaktesimit duhet te jete i rrafshet, i paster, i kompaktuesar dhe i pershtatshem per te vazhduar me ndertimin e paketes se shtresave rrugore.

5.1 Shtresat me gur te copetuar

Karrierat e pershtateshme, te aprovuara nga Punedhenesi, do te perdoren per te marre dhe transportuar materialin ne kantierin e punimeve. I gjithe materiali i nevojshem do te ndahet ne grumbullime te caktuara. Zonat e grumbullimit do te jene te pregatitura dhe te ndertuara sipas Specifikimeve Teknike. Te gjitha shpenzimet gjate prodhimit, transportit dhe grumbullimit te materialeve te teperta jane aksidentale dhe jo te parashikuara ne koston e prodhimit te aggregateve specifike. Granulometria e aggregateve baze qe do te sherbejne per ndertimin e shtratit te rruges do te jete sipas kerkesave specifike te projektit. Materialet e fragmentuara qe do te perdoren gjate punes do te jene sipas standardeve dhe kushteve teknike per punimet ndertimore dhe gjithashtu ne perputhje me specifikimet teknike te projektit.

Agregatet e perdorura per ndertimin e shtratit te rruges do te jene grimca ose fragmente te qendrueshme, Materiali do te jete pa prezence te bimesise apo substancave te tjera shkaterruese. Agregatet e perdorura per shtresat baze dote jene te qendrueshme gjate kompaktesimit me sperkatje dhe cilindrim. Agregati i gurit te grimcuar dote permbaje jo me shume se tete (8) perqind, nga pesha, copa te sheshta, te zgjatura, te buta ose te shperbera. Agregati i mbetur ne site 2.36 mm (Nr. 8) do te perbehet nga grimca guri, nga te cilat te pakten nentendhete perqind (90%), per nga pesha, dote kene te pakten dy (2) faqe te thyer mekanikisht.

Prodhirni i materialeve do te kryhet duke perdorur therrmues te levizshem dhe impiante te kontrollimit te levizshem ne pronesi ose me qira nga Kontraktuesi. Fabrika e therrmimit dhe copëzimit të gurit të therrmuar do të instalohet ose do të përdoren ato që janë të instaluar të përcaktuara si më poshtë:

Para ndertimit te paketes se shtresave rrugore, ne do te ndermarrim realizirnin e testeve te nevojshme per kontrollin specific te fragmentimit, granulometries dhe

cilesise gjate prodhimit. Materiali i fragmentuar nuk dote permbaje shkemb te shperbere apo material argjilor. Pasi rezultatet e testimit te jene konform kerkesave per granulometrine dhe te aprovohen nga Punedhenesi, ne jerni gati te fillojme me punimet ndertimore.

Megjithate, rezultatet e proves kane per qellim te perdoren si nje udhezues, por jo te perdoren per te konstatuar se agregatet qe prodhohen jane te pranueshme dhe ne perputhje me specifikimet.

Punedhenesit do t'i garantohet aksesit ne veprimet e marrjes se mostrave dhe testirnit te materialeve ne cdo kohe.

5.2 Ndertimi i paketes se shtresave rrugore

Materiali per formimin e mbushjes dote vendoset ne shtresa me trashesi qe nuk tejkalojne projektin(lartesine) dhe ne perputhje me "Specifikimet Teknike".

Shtresa dote perhapet nga grejder. Shtypja dote behet minimalisht nga nje vibrator kompaktues 12 tonesh.

Cdo shtrese stabilizanti dote kompaktohet ne nje dendesi uniforme nentedhjete e pese perqind (95%) te peshes maksimale te njesise se thate te percaktuar nga AASHTO T1 80. Cdo pjese e materialit baze sic pershkruhet ne "Specifikimet Teknike" do te kete nje ngjeshje relative jo me pak se njeqind perqind (100%) te peshes maksimale te njesise se thate te percaktuar nga AASHTO T180.

Cdo shtrese do te kete densitetin e mesiperm te kompaktuar, duke kerkuar tharje paraprake nese materiali eshte shume i lagesht ose teper i thate, per te arritur nje ndryshim lageshtie jo me shume se $2 \pm$ pike nga lageshtia normale e paracaktuar ne laborator, dhe gjithmone me e ulet se kufiri i kontraktimit per tokat plastike.

Shtresa e kompaktësuar do të mirmbahet në një gjëndje optimale gjatë punimev etë ndërtimit në përputhje me specifiimet teknike dhe do të testohet për ngjeshje në përputhje me kërkesat teknike. Dendesia e ngj eshur per secilen shtrese te bazes agregate do te percaktohet me metoden e konit te reres, AASHTO T191 ne perputhje me "Specifikimet Teknike", Per te ruajtur cilesine e shtresave te rruges sipas Specifikimeve Teknike, ne do te kryejme dhe kujdesemi maksimalisht per procedurat e tjera te sigurimit te cilesise ne perputhje me Granulometrine e Agregateve, Indeksi ekuivalent i Reres dhe Indeksi i Plasticitetit, CBR dhe Abraziviteti, Tolerancat ne siperfaqe. (Shih shtojcen 5)

Siperfaqja e siperme e seciles shtrese do te jete ne perputhje me kerkesat e lartpermendura per siperfaqen ne nje punim te perfunduar.

- 6. NDERTIMI

Kushtet e lejuara te motit

Shtresa asfaltike nuk do te aplikohet kurrresi ne siperfaqe te lagesht ose te ngrire gjate stuhive dhe cdo gjendje tjeter te keqe te motit. Normat e temperaturave te lejuara per te vazhduar me punimet e shtreses asfaltike do te jene ne perputhje me Standardet dhe Specifikimet Teknike.

Kompaktesimi

Shtresa asfaltike bituminoze do te perhapet dhe mbulimi fillestar ose kompaktimi i prishjes do te kryhet kur temperatura e perzierjes nuk eshte me pak se 140°C dhe i gjithe rulimi do te perfundoje para se temperatura e perzierjes te bjere nen 90°C. Se pari dote rulohen nyjet gjatesore, dhe pastaj ruliimi dote filloje ne skajin e poshtem dhe dote vazhdoje drejt pjeses mete larte. Dote sigurohen pajisje te mjaftueshme per ngjeshje dhe rulimi do te vazhdoje derisa te jete perfunduar cdo pjese e shtreses asfaltike bituminoze.

Punimet riparuese

Punimet riparuese te shtresave asfaltike perfshijne:

- *Gropat*
 - *Arnimet*
 - *Plasaritjet*
 - *Nivelimet (Rutting) Thermimi (Ravelling)*
- Anet e thermuara te shtreses asfaltike (Loose pavement edge)*

Punimet e riparimit do te kryhen duke hequr dhe pastruar zonen e demtuar. Kjo mund te behet duke perdorur pajisje pastrimi me ane te ajrit me presion brenda plasaritjeve, vrimave, zones se rutting etj., Ose me makineri copetimi asfalti mekanik ne rast te zones se derntuar me madhesi mesatare. Pas përfundimit të veprimeve të mësipërme sipërfaqja spërkatet mëe emulsion të bitumi që mbulon të gjithë zonën. Pas kohës së përcaktuar në specifikimin teknik dhe standartit duke marrë parasysh edhe gjendjen e motit (temperaturat, lageshtine etj), materiali asfaltik do te vendoset ne zone. Pas kesaj do te vazhdoje kompaktimi.

6.1 Menaxhimi i Trafikut

Gjate ndertimit te shtreses asfaltike, trafiku nuk do te lejohet derisa procesi 1 shtresezimit te perfundoje. Trafiku do te menaxhohet duke perdorur sinjalistika pergjate rruges.

Te gjitha punimet e shtreses asfaltike dote kryhen ne perputhje te plote me Rregullat dhe Standardet e Sigurise, ne menyre te sakte, sipas dokumentit manual "Udhezimeve operative per menaxhimin dhe mirembajtjen e rrugeve".

7. DERGIMI, RUAJTJA DHE TRAJTIMI

Materialet e sjella ne kantier duhet te inspektohen per ndotje dhe demtim. Materialet duhet te shkarkohen dhe ruhen me nje minimum trajtimi. Agregatet duhet te ruhen ne menyre te tille qe te parandalojne ndarjen dhe ndotjen.

Kerkesat Mjedisore

Aplikimi i shtreses bituminoze do te behet vetem kur siperfaqja ekzistuese ose shtresa baze eshte e thate ose permban lageshti jo me te madhe se sasia qe do te lejoje shperndarjen e njetrajtshme dhe ngjitjen e deshiruar. Trajtimi i shtreses bituminoze nuk do te zbatohet kur:

- 1. Temperatura atmosferike ne hije eshte me pak se 10-15.5 °C;*
- 2. Siperfaqja qe dote trajtohet eshte nen 20°C;*

pervец nese udhezohet ndryshe.

Pajisjet

Do te sigurohen pajisje te besueshme dhe te pershtatshme per qellirnin e synuar dhe te mirembajtura ne gjendje operative te kenaqshme dhe te sigurt ne cdo kohe. Do te nderpritet perdorimi i pajisjeve qe nuk japin rezultate te kenaqshme dhe dote zevendesohen me pajisje te pershtateshme. Dote perdoren pajisje te kalibruara si shperndares asfalti, peshore, perzieres, shperndares dhe pajisje te ngjashme.

- Shperhapes bitumi*
- Rula kompaktesues*
- Shpemdares mekanik*

APLIKIMI

Shtresa asfaltike bituminoze do te vendoset ne trashesi dhe dimensione horizontale, ne perputhje me vizatimet dhe Specifikimet Teknike. Referuar seksioneve terthore tipike, shtresa e tapetit asfaltik do te vendoset me trashësi 5cm dhe shtresi Binder me trashësi 8 cm (megjithatë trashësia e shtresës do të jetë sipas hetimit të terrenit).

Materialet bituminoze do te dorezohen ne kamione me depozite fundore, dhe me pas do te ngarkohen ne makinerine e shtrimit; pajisjet e ngarkimit do te jene vete-mbeshtetese dhe nuk do te ushtrojne ndonje ngarkese vertikale ne makinën e shtrimit. Shtresa asfaltike

bituminoze do te vendoset gjate <lites. Punimet e shtreses asfaltike bituminoze dote ekzekutohen gjate nates vetem ne kushte te rralla dhe vetem nese kjo miratohet nga Inxhinieri Mbikeqyres.

8. Punimet e mbushjes

Materiali qe do te perdoret per mbushje do te jete ai i aprovuar dhe certifikuar paraprakisht nga Inxhinieri Mbikeqyres. Materiali do te vendoset ne shtresa prej 15cm dhe do te kompaktohet neperrnket pllakave ngjeshese dhe rulave. Shtresat dote testohen ne menyre qe te garantohet nje nivel kompaktimi prej 95% sipas Specifikimeve Teknike.

E njejta procedure dote ndiqet edhe per tombinot rrethore.

Punimet riparuese te tombinove konsistojne ne riparime te vogla ose nderhyrje te medha ne strukturat hyrese ose dalese te tombinove. Nderhyrjet e medha dote ndermerren ne te njejten menyre te pershkruar ne paragrafin e mesiperm. Nderhyrjet e vogla dote konsistojne ne riparimet e kokes se tombinos, pjeses hyrese, dalese etj. Keto nderhyrje dote kryhen me dore duke perdorur materiale dhe masa te paracaktuara paraprakisht ne projekt.

Te gjitha punimet e lartpermendura do te kryhen ne perputhje me Rregullat dhe Standardet e Sigurise ne menyre korrekte pas manualit "Udhetime Operative per menaxhimin dhe mirembajtjen e rrugeve".

Murel

Ka disa zona gjate trupit te rruges ku skarpatat duhet te stabilizohen nepermjet mureve mbajtes. Punimet ndertimore per muret mbajtes konsistojne me se shumti ne punime betoni ose guri. Keto punime do te kryhen menjehere pas germimit te skarpates dhe stabilizimit te saj ne menyre qe te evitohet cdo rrezik per rreshqitje dheu apo aksidente te tjera ne kantier.

Punimet ndertimore dote realizohen ne zonat e caktuara nga Projektuesi, ose ne zonat e konsideruara sijo te sigurta gjate procesit te punes. Pjese guri te palidhur ose dhe i paqendrueshme qe mund te shkeputet lehtesisht nga siperfaqja e skarpates dote hiqen. Pas perfundimit te punimeve te germimit, dote perhapet dhe kompaktohet shtresa e stabilizantit. Pas saj, dote perhapet shtresa e betonit te varfer.

Ne rastin e ndertimit te mureve mbajtese prej betoni, do te filloje procesi i karpenterise dhe lidhjes se hekurit (nese parashikohet ne projekt). Betoformat dhe hekuri per perforcim do te vendosen sipas projektit. Pas perfundimit te punimeve te perforcimit dhe kontrollit nga Inxhinieri i Strukturave, do te filloje procesi i betonimit. Betoni do te prodhohet ne nyjen e betonit dhe do te transportohet nepermjet betonieres. Nese dote jete e nevojeshme, betoni dote derdhet nepennjet nje pompe betoni. Pasi punimet e betonit te

kene perfunduar dhe betoni te kete arritur fortesine e duhur, te vertetuar nepermjet testeve ne shtypje te kubikeve te betonit, dote fillojne punimet e mbushjes.

Materiali qe dote perdoret per mbushje dote jete ai i aprovuar dhe certifikuar paraprakisht nga Inxhinieri Mbikeqyres.

Muret e gurit do te ndertohen duke perdorur gur te miratuar paraprakisht ose te parasbikuar ne projekt. Materiali shkembor dote vendoset ne rreshta me permasat e dhena ne projekt. Ndertimi i mureve te gurit do te behet nga punetore te specializuar te ndihmuar nga punetore ndihmes.

Muret e gabionit do te ndertohen ne te njejten menyre te pershkruar per muret e gurit. Guret do te vendosen Brenda kutive gabion te galvanizuar dhe keto kuti do te pozicionohen ne rreshta sic eshte parasbikuar ne projekt.

Punimet e riparimit te mureve do te ndahen ne nderyrje te vogla si psh nderhyrje ne zona te vogla duke perdorur materiale te specifikuara ne projekt, ose ne nderhyrje te medha. Nderhyrjet e medha do te zhvillohen duke prishur nje pjese ose te gjithë murin ekzistues dhe duke e rindertuar.

Mbrojtjet e Skarpates

Kemi konsideruar si opsion, nese do te jete e nevojeshme, mbrojtja e skarpates duke perdorur rrjete te galvanizuar aty ku skarkapta e germimit dote kete nevojë per perforcim si pasoje e pranise se formacionit gjeologjik te dobet. Punimet per stabilizimin e skarpates, me se shumti konsistojne ne perdorimin e shufrave prej celiku te galvanizuar te instaluar ne vrima te shpuara, te mbushura me llac cemento, te fiksuara me pllaka dhe dado te galvanizuar dhe te mbuluara nga nje rrjete celiku e galvanizuar. Ky trajtim do te kryhet njekohesisht me punimet e germimit, dhe germimi ne zonen pasaedhese do te vazhdoje vetem pas stabilizimit te zones paraardhese ne menyre qe te evitohet cdo rrezik per rreshqitje te dheut apo aksidenteve te tjera ne kantier.

Mbrojtja e skarpatave do te realizohet ne zonat e paracaktuara nga Projektuesi, ose ne ato zona qe do te konsiderohen te pasigurta gjate proceseve te punes. Pjese guri te palidhur ose dhe i paqendrueshme qe mund te shkeputet lehtesisht nga siperfaqja e skarpates do te hiqen. Qellimi i mbrojtjes se skarpatave eshte te perforcoje skarpaten ne menyre qe te mbroje rrugen, personelin dhe mjetet e trafikut nga rreshqitja e dheut.

Cdo punetor qe dote realizoje mbrojtjen e skarpates dote jete i lidhur ne dy pika te ndryshme ankoruese ne maje te skarpates. Per te pozicionuar pikat ankoruese dote perdoret nje vinc-kosh I shoqeruar me nje telekomande e cila do te perdoret per te ngritur njerezit (kapacitet maksimal 56kg ne nje lartesi maksimale).

Metodologjia e punes per mbrojtjen e skarpates dote permbaje fazat e meposhteme te punes.

1. Puna dote realizohet nje nje seksion te vecuar ne 2-3 zona, ne varesi te nurnrit te punetoreve.

2. Cdo grup pune dote kete nje drejtues.

3.Cdo punetor ose operator ngjites do te realizoje cdo process pune ne perputhje te plote me rregullat e sigurimit Teknik dhe do te jete gjithmone i lidhur me litar ne ankerat e sigurise te instaluara paraprakisht.

4. Pas instalimit te ankerave ne te gjitha skarpaten, sic kerkohet ne Projekt, ngjitesit do te procedojne me mbushjen me llac cemento te injektuar ne vrimat e hapura per pozicionimin e ankerave derisa llaci i ciementos te mbushet cdo vrimë. Punonjësiti që do të realizojnë mbushjen me llac cemento do te jene te lidhur ne dy pika ankorimi ne maje te skarpates dhe do te kene gjithashtu nje litar shtese qe do ti sherbeje.

5.sherbejne per terheqjen e tubit te pompes injektuese nga toka ne vendin e duhur te punes.Pajisja per injektimin e llac cimentos Atlas Copco MAI NT 400 punon ne nje presion maksimal prej 50 bar dhe ka tuba qe arrijne deri ne 70m. Presioni normal gjate injektimit te Bae cimentos eshte 10/15 bar. Cdo operator ose ngjites do te realizoje cdo proces pune ne perputhje te plote me rregullat e sigurimit Teknik dhe do te jete gjithmone i lidhur me litar ne pikat e fiksuara te ankerimit. Te dhenat teknike te llac cimentos qe do te perdoret do te jene konform Specifikimeve Teknike.

Instalimet e pllakave dhe dadove e bulonave do te jene lotesisht te fi.ksuara. Kur llac cemento te kete arritur 95% te fortesise se tij nominale, verifikim qe do te kryhet nepermjet Inxhinierit QA/QC, nepermjet testimit te .kampioneve. Punetori qe dote operoje ne instalimin e pllakave dhe bullonave do te jete i lidhur me litar ne dy pika te ndryshme ankorirni ne maj te skarpates, dhe gjithashtu do te kete nje litar shtese i cili do ti sherbeje per marrjen e pllakave dhe bullonave e dadove nga toka ne vendin e punes. Per shtrengimin e dadove, punetori do te perdure nje celes te lidhur me nje litar te holle ne veshjen e tij.

7.Tubat e drenazhit dote instalohen nepermjet shpimit ne beton dhe me pas instalimit te tubave.

8. Aktivitetet do te perseriten derisa te plotesojne te gjitha mbrojtjen e skarpates.

Te gjitha punetoret dhe ngjitesit do te jene te pajisur me veshje mbrojtese dhe gjate punimit ne skarpate do te jene te lidhur me dy litar sigurie ne dy pika te ndryshme ankorimi.

9. BARRIERAT E SIGURISE

Punimet e sigurise perfshijne fumizimin dhe vendosjen e kufizueseve "guardrails" pergjate trupit te rruges. Punimet ndertimore konsistojne ne fi.ksimin e shtyllave te guardreilave derisa te arrije thellesine e projektuar te zhytjes. Shtyllat do te vendosen ne nje distance prej njera tjetres sic eshte parashikuar ne projekt. Pas pozicionimit te sakte te shtyllave, elementet horizontal te gardreilave do te pozicionohen te njerit tjetri nepermjet bulonave te galvanizuar. Kjo procedure do te perseritet derisa e gjitha gjatesia

e parashikuar ne projekt te jete e mbrojtur. Te gjithë gardreilat dote jene konform standardit EN 1317 dhe Standarteve Shqiptare.

Te gjitha punimet per barrierat e sigurise do te ndermerren ne perputhje me Regullat e Sigurise dhe Standardeve dhe ne perputhje me manualin "Udhezime operative per menaxhimin dhe mirembajten e rrugeve".

10. SHENJAT E TRAFIKUT DHE SINALISTIKA

Punimet lidhur me shenjat e trafikut dhe sinjalistiken konsistojne ne zevendesimin ose rifreskimin e sinjalistikes vertikale dhe horizontale. Shenjat vertikale do te vendosen duke fi.ksuar me pare nje shtylle metalike mbajtese te fi.ksuar ne vetvete ne nje bazament betoni. E gjithë sinjalistika vertikale do te vendoset ne perputhje te plote me projektin dhe Manualin Shqiptar te Sinjalistikës Rrugore dhe ARDM 6.

Per segmented rrugore me limit shpejtesie 80km/h do te perdoren tabela te permasave mesatare, dhe per segnentet me shpejtesi te lejuar mbi 80:Ir..m/h, do te perdoren tabela te permasave te medha.

Sinjalistika horizontale kosniston ne vijeizimet e rruges, percaktuesit e rruges etj. Vijeizimet e rruges dote jene me boje bikomponente ne perputhje me Standardet Europiane. Vijeizimet dote behen duke perdorur makinat e posacme vijezuese.

Te gjitha sinjalistikat rrugore dhe vijeizimet do te behen ne perputhje te plote me Rregullat e Sigurise dhe Standardeve duke ndjekur manualin "Udhezime operative per menaxhimin dhe mirembajtjen rrugore".

11. MIREMBATJADIMERORE

Punimet e mirembajtjes ne kushtet dimerore do perfshijne:

1.Punime paraprake para fillimit te kushteve te dimrit, ku perfshihet organizimin e puneve ne dy kantieret njeri ne fillimin e kontrates i cili eshte kantieri i AEK Munella Shpk I cili ndodhet ne afersi te Km 1 te objekti dhe tjetri i cili eshte i DRINI-1 I cili ndodhen ne km 56.8 te objektit..

2. Organizimi i vendodhjeve te depozitimit te materialeve (kripes dhe mjeteve) gje e cila eshte bera per arsyeje se kemi krijuar rezerva te mjaftueshme nga kontratat e meparshme dhe poi afroherni periudhes dimerore gje e cila te qone ne marrjen e masave.

3. Masat mbrojtese per boren, akullin, grumbujt e bores dhe orteket.

4.Organizimin per raportimin e informacionit 24 ore/24 organeve kompeten.

Me poshte ju paraqesim dhe nje here kapacitetet teknike dhe njerzore te B.O: Staf i inxhinierik dhe teknik i AEK Munella Shpk:

1. Ing Ndertimi Pranvera ELEZI e Certifikuar si "Pergjegjes per Sigurine dhe Mbrojtjen e Shendetit ne Pune.

2.Ing Gjeodet Zef KAZA i Certifikuar si "Pergjegjes per Sigurine dhe Mbrojtjen e Shendetit ne Pune.

3. Ing Gjeodet Zef KAZA i Certifikuar si "Punimet ne lartesi D.P.I,Renie nga lartesia(D.P.I skela,shkalle,skarpata etj)
4. Inxhinier Gjeolog Gjon KAZA
5. Inxhinier Mekanik Mirjan VERCANI
6. Inxhinier Hidroteknik Vladimir VASI
7. Inxhinier Elektrik Xhavid GJERDUMI
8. Bardhok BARDHI i certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
9. Ferdinand LLESHI i certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
10. Kristian KAZA certifikuar si "Ekspert per ndihrenen e pare dhe nderhvrjen ndaj emergjencave" dhe manovrator i makinerive te renda
11. Eduart BARDHOCI certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
12. Zef BARDHOCI certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
13. Vladimir LASKA certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
14. Kujtim LIKA certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
15. Aflred Gjoka certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
16. Llesh Kacorri certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
17. Nikoll Lazri certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
18. Fran Lika certifikuar si manovrator i mjeteve te renda

Stafi inxhinierik dhe teknik i DRINI-1Shpk:

1. Inxhinier Ndertimi Fiqerete Xhura
2. Inxhinier Elektrik Alfred Gjergji
3. Inxhinier Mekanik Pjeter Alia
4. Inxhinier Maksheder Lek Cuku
5. Inxhinier Mjedisi Silvana Jonuzi
6. Jetmir Gjergjaj i certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
7. Gjergj Seferi i certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
8. Musa Hadroj i certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
9. Halit Qaraj i certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
10. Frederik Nikaj i certifikuar si manovrator i mjeteve te renda
11. Viktor Nika i certifikuar si manovrator i mjeteve te renda

Jane ne dispozicion dhe 29 punonjes te tjere te B.O.

Me poshte do te gjeni listen e makinerive te cilat shumica e tyre jane ne pronesi dhe makineri te tjera qe jane akoma ne dipozicion te objektit:

MAKINERITE

Me poshte do te gjeni listen e makinerive te cilat shumica e tyre jane ne pronesi dhe makineri te tjera qe jane akoma ne dipozicion te objektit:

MAKINERITE					
Lloji i Mjetit	Targa	Pronesia	Afati i Kontrates se qerases	Nr Ljes se qarkullimit ose dokument pronesie	SASIA
1. Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 tonë	AA438YN	Me qera Nr 3834Rep dt01.08.2020	4 vjecare		COP 1
2. Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 tonë	AA995SC	Me qera Nr 3834Rep dt01.08.2020	4 vjecare		COP 1
3. Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 tonë	AA683MO	Ne Pronesi		SHD1886015	COP 1
4. Grejder		Me qera me nr kontrate LRP4619 dr 30.07.2020	4 vjecare	Fature Nr 7dt 18.05.2016 dhe nr shasle 107376	COP 1
5. Rrul vibrues		Ne pronesi		Fature Doganore R47692 dt 01.07.2008	COP 1
6. Rrul vibrues		Ne pronesi		Fature Nr 82 dt 14.10.2008	COP 1
7. Prerese asfalti		Ne pronesi		Deklarate Nr2880Rep dt 21.05.2019	COP 1
8. Prerese asfalti		Ne pronesi		Fature Nr 62 dt 24.11.2010	COP 1
9. Freze Asfalti		Me qera me nr kontrate LRP4622 dr	4 vjecare	Fature doganore Nr R25817 DT 14.	COP 1

		30.07.2020		12.2016	
10. Betoniere		Ne pronesi		Fature nr 80 dt 24.04.2018	COP 2
11. Betoniere		Ne pronesi		Fature doganore R 24627 DT 25.05.2010	COP 1
12. Autobot Uji	05-644-EN	Me qera me nr kontrate LRP4619 dr 30.07.2020	4 vjecare	1437648	COP 1
13. Autobitumatrice		Me qera me nr kontrate LRP4740 dr 04.08.2020	4 vjecare	Fatura Nr 35/06 dt 28.08.2006	COP1
14. Asfaltshtruse		Me qera me nr kontrate LRP4622 dr 30.07.2020	4 vjecare	Fature doganore 25817	COP 1
15. Motomjet ose Agregatë për prerjen e bimësisë së ulët		Ne pronesi		Fatura nr 05 date 04.03.2020 dhe Fatura nr 169 dt 19.07.2017	COP 6
16. Kamioncine	SH8081E	Ne pronesi		SHF0836212	COP 1
17. Kamioncine	AA209IP	Ne pronesi		LAF0427614	COP 1
18. Mini eskavator		Ne pronesi		Deklarate Nr 2880 Rep dt 21.05.2019	COP 1
19. Bob Cat		Ne pronesi		Fature Nr 24 dt 25.05.2016	COP 1
20. Bob Cat		Ne pronesi		Fatura nr Nr 82 dt 14.10.2008	COP 1
21. Fadrome	AAMT82	Ne pronesi		LAF0216813	COP 1

22.Fadrome		Ne Pronesi		Fature doganore R 28454	COP 1
23.Eskavator me zinxhir		Ne pronesi		Fature doganore R 51309	COP 1
24. Eskavator me zinxhir		Ne pronesi		Fature nr 17 dt 29.03.2012	COP 1
25. Eskavator me goma		Me qera me nr kontrate LRP4622 dr 30.07.2020	4 vjecare	Fature doganore R 16837 dt06.06.2013	COP 1
26.Makineri per vijezim rrugore		Me qera me nr kontrate LRP 4718dt 04.08.20	4 vjecare	Fature doganore 0015273	COP 1
27. Badipal		Me qera me nr kontrate LRP4625 DT 30.07.2020		Fature doganore R 54412	
28.Fabrike asfaltobetoni		Kontrat furnizimi Nr 3835Rep dt01.08.2020	4 vjecare		COP 1
29.Borepastruese	AA756IB	Ne pronesi		LAD0537314	COP 1
30.Borepastruese	AA718GU	Ne pronesi		LAF0217013	COP 1
31.Borepastruese	AA682MO	Ne pronesi		SHD1885915	COP 1
32.Borepastruese	AA584MO	Ne pronesi		SHD1886215	COP 1
33.Set semafor per menaxhim trafiku		Ne pronesi		Fatura nr 05 date 04.03.2020	COP 2

Ne 39 makineri qe kerkohen 11 jane te marra me qera e cila eshte 28% e totalit dhe 28 jane ne pronesi. Pervet ketyre B.O ka ne dispozicion per kete objekt edhe makineri te tjera dhe staf mbeshteses.

Ne mbeshtetje te LPP Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10/309, date 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017, Neni 55 Pika 2: Autoriteti

Ne 39 makineri qe kerkohen 11 jane te marra me qera e cila eshte 28% e totalit dhe 28 jane ne pronesi. Pervet ketyre B.O ka ne dispozicion per kete objekt edhe makineri te tjera dhe staf mbeshteses.

Referojmë LPP-në [...]

Ne mbeshtetje te argumentave te mesiperm kemi dhe sa me poshte:

Ne LPP Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, date 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, date 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, date 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, date 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017, Neni 53 Pika 4 "Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo permban devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndryshojne thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si Edhe gabime shtypi të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

Ne LPP Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, date 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, date 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, date 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, date 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017, Neni 55 Pika b) oferta ekonomikisht me e favorshme, bazuar ne kriteret te ndryshme te lidhura me objektin e kontrates qe prokurohet, si: cilesia, cmimi, cilesite teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmeria ekonomike, sherbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periodha e levrimit ose periodha e ekzekutimit, me kusht qe keto kriteret te jene objektive dhejodiskriminuese.

Ne mbeshetjet e Nenit 55 te LPP Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, date 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, date 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, date 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, date 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017, Pika 5 : Autoriteti kontraktor percakton oferten me te mire pas krahasimit dhe vleresimit te ofertave

Ne mbeshetjet e Neni 31 pika 2 te VKM Nr. 914, date 29.12.2014 "PER MIRATIMIN E RREGULLAVE TE PROKURIMIT PUBLIK, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 402, DATE

13.05.2015, ME VENDIMIN NR. 823, DATE 23.11.2016 ME VENDIMIN 797, DATE 29.12.2017 DHE ME VENDIMIN NR. 80 DATE 14.2.2018 : Kriteri i ofertes ekonomikisht me te favorshme do te perdoret ne kontrata komplekse dhe te nje natyre te vecante qe pervec cmimit per punen/mallin/sherbimin, objekt i kontrates, permbajne dhe elemente te tjera, qe kane vlere ekonomike dhe i ngarkojne autoritetin kontraktor shpenzime te tilla, si kostot e sherbimeve pas shitjes, pjeset e kembimit, zgjidhjet me tefavorshme teknike, mbeshetjen teknike ne te ardhmen apo ato qe ndotin me pale mjedisin.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në rast, kur kriteret janë me shume se nje, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë me pak se 50 pike. Piket maksimale që dote marrë nje oferte do të jenë JOO pike. Për kriteret vlerësuese duhet percaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht piket që do të ketë çdo kriter dhe menyra e llogaritjes së pikeve për ofertuesit e njepasnjeshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

Në këtë kusht pikezimi i ofertes sone është i padrejtë dhe i pa bazuar në ligje.

Prandaj në mbeshetjet e Nenit 78 të VKM Nr. 914, date 29.12.2014 "PER MIRATIMIN E RREGULLAVE TE PROKURIMIT PUBLIK, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.

402, DATE 13.05.2015, ME VENDIMIN NR. 823, DATE 23.11.2016 ME VENDIMIN 797, DATE 29.12.2017 DHE ME VENDIMIN NR. 80 DATE 14.2.2018, kërkojmë pranimin e kërkesës dhe rivlersirnin e pikezimit të ofertes sone.

Ne rast te kundert kemi dyshime se autoriteti kontrktore eshte ne kushte e Nenit 26 te LLPP nr, 9643 DATE 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, date 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, date 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, date 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, date 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017.

Ne raste mos rivlersimi te ofertes tone bazuar ne Nenin 63 pika 6 te LPP Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, date 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, date 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, date 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, date 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017 do t'ju drejtohem organeve kompetente.[...]

II.7. Në datën 23.10.2020 nëpërmjet shkresës me nr.7888/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur pranimin pjesërisht të ankesës me argumentat në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi vleresirnin me pike per treguesit dhe analiza cilesore ne pune duke percaktuar elementet e saj si per shembull por pa u limituar ne cilesine e propozimit teknik per sa i perket metodave te perdorura, personelit kryesor, disponueshrnerise se pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit te cilesise, planit te mobilizimit, grafikut te punimeve dhe cdo aktiviteti tjetër sic mund të përcaktohet nga punëdhënësi, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave , konstaton se, eshte paraqitur dokumentacion ne lidhje me metodat e perdorura, personelit kryesor, disponueshrnerisese pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit te cilesise, planit te mobilizimit, grafikut te punimeve te kerkuar ne dokumentat e tenderit. Nga shqyrtimi i tyre konstatohei se, ka metodologji te perdorura, paraqitje te personelit kryesor, disponueshrneri te pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit te cilesise, planit te mobilizimit, grafikut te punimeve, duke vertetuar se ka treguesit cilesore ne pune sipas objektit te prokurimit. Komisioni, gjykon se, procesi i pikezimit ne procedurat qe kane si kriter te perzgjedhjes se fituesit oferten ekonomikisht me e favorshme, duhet te behet ne perputhje dhe ne proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjeter, duhet te jete sa me afer kerkesave dhe kriterëve te percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit te prokurimit publik, eshte e tille qe, cdo operator duhet te pergatise oferten e tij ne perputhje me kriteret dhe kerkesat e parashikuara ne dokumentat e tenderit. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave , sqaron se, vleresimi me pike bazohet ne gjykimin personal dhe individual te secilit prej anetareve te komisionit te vleresimit te ofertave, brenda diapazonit me pike, te percaktuar ne dokumentat e tenderit, por nga ana tjeter ky vleresim dhe gjykim, nuk duhet te jete subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesernarres ne proceduren e prokurimit. Komisioni i vleresimit te ofertave, ka vleresuar me nga 17 pike operatorin ekonornik ankimues lidhur me kete pike duke mos vleresuar as me minimumin e pikeve dhe as me maksimumin e tyre. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave gjykon se, vleresirni eshte i matshem ne kushte kur niveli i pikezimit eshte ne raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vleresimi me pike jepet duke analizuar analizat cilesore ne pune, Persa me siper, referuar dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik*

ankimues lidhur me treguesit dhe analiza cilesore ne pune, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave gjykon se, komisioni i vleresimit te ofertave nuk ka bere nje vleresim te arsyeshem. Referuar dokumentacionit te paraqitur nga operatori ankimues ne lidhje me metodat e perdorura, personelit kryesor, disponueshmerise se pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit te cilesise, planit te mobilizimit, grafikut te punimeve te kerkuar ne dokumentat e tenderit., Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave gjykon se Komisioni i Vleresimit te Ofertave duhet te kishte vleresuar me maksimumin e pikeve lidhur me kete pike pra 20 pike .

Sa me sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me këtë pikë qëndron.

II.6. Në datën 03.11.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjta pretendime si edhe në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 8631/1 prot., datë 10.11.2020, protokolluar me tonën me shkresën nr.1404/2 datë 12.11.2020 me objekt “*Informacion mbi zhvillimin e procedurës* ”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini-1” sh.p.k. mbi kundërshtimin e vendimit të KVO lidhur me vlerëimin e tij në pikë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 3, pika 18 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Procedurë e kufizuar*” është procedura, përmes së cilës çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë, por vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor mund të dorëzojnë oferta.

III.1.2. Në nenin 31 “Kriteret për Vlerësimin e Ofertës”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet*

më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë.

Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

III.1.3. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 4, “Kriteret e vlerësimit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

Kjo procedurë përfshin dy faza kryesore

Faza 1 – Parakualifikimi: Kandidatët do të dorëzojnë dokumentat e kërkuara në DT. Autoriteti Kontraktor do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e kualifikimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Faza 2 - Ftesa për Ofertë: Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët, të cilët, kanë plotësuar kërkesat për parakualifikim duke i ftuar të dorëzojnë një ofertë teknike dhe ekonomike. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën fituese.

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **çmimi më i ulët** ☐

Ose

B) ☐ **oferta ekonomikisht më e favorshme** ☒

lidhur me rëndësinë: Çmimi ☐☐ **pikë**☐

etj. ☐☐ **pikë**

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) **Çmimi më i ulët**

[0-60]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(ii) **Pervoja ne pune e kompanise**

[0-20]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e relalizuuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit.

(iii) Cilësia

[0 - 20]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

III.1.4. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se faza e dytë e procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të tre elementëve kryesorë, të tillë si oferta ekonomike më e favorshme, Pervoja ne pune e kompanise dhe cilësia e cila përfshin treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Komisioni i Prokurimit Publik në analize të dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini-1” sh.p.k. në fazën e dytë të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstaton se në lidhje me komponentin e parë oferta ekonomike më e favorshme ka parqitur formularin e ofertës në vlerën 197.273.824 lekë pa tvsh.

Ndërkohë sa i takon objektit fillestar të ankesës së BOE ankimues lidhur me metodologjinë e propozuar referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ e konkretisht informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se ankesa e bashkimit të operatorëve ekonomikë në lidhje me pikëzimin e ofertës së tij në drejtim të metodologjisë është pranuar dhe autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës së prokurimit, dhe ka vlerësuar me pikë maksimale (20 pikë) ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë lidhur me këtë komponent.

Nga ana tjetër, KPP konstaton se KSHA ka pranuar pjesërisht ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë duke mos u shprehur në këtë mënyrë në lidhje me pretendimet që ky i fundit ka në drejtim të metodologjisë së vlerësimit nga ana e autoritetit kontraktor për dy operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar në drejtim të metodologjisë. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se metodologjia e propozuar nga ana e operatorit ekonomik “Jubica” shpk është vlerësuar me 20 pikë maksimale ndërsa BOE ALB Shpresa&Mela&Xhast shpk është vlerësuar me 17 pikë.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Jubica” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kështu, në drejtim të grafikut të zbatimit të

punimeve, ky i fundit ka deklarua për punimet e rehabilitimit të realizojë brenda 12 muajve, ndarë në disa grupe punimesh, punimet e riparimit/mbushjes së të gjithë gropave, vendosja e sinjalistikës vertikale dhe barrierave mbrojtëse, stabilizimit të dherave në rrugë (pastrim i tyre, ndërtim i mureve të thjeshtë mbajtës) në sipërfaqen e rrugës brenda 2 muajve të parë nga lidhja e kontratës, ndërkohë punimet e tjera si punime të shtresave asfaltike, të sistemimit të skaprave, riparimit të bankinave, për veprat e artit si edhe për strukturat beton arme brenda 13 muajve të parë nga lidhja e kontratës. Ndërkohë, referuar grafikut të punimeve të deklaruar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” shpk & “Drini 1” shpk është deklaruar realizimi i punimeve të rehabilitimit dhe periodike brenda 6 muajve, duke nisur nga muaji i katërt në muajin e dhjetë brenda vitit të parë, në një periudhë në total ndjeshëm më të shkurtër se sa ajo e operatorit ekonomik “Jubica”.

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë përfaqësuar nga operatori ekonomik “Alb Shpresa” shpk rezulton se nuk është dorëzuar grafik i detajuar i propozimit të punimeve.

III.1.5. Akoma më tej në lidhje me metodologjinë në tërësi të dorëzuar, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi mori në shqyrtim në rrafsh krahasimor metodologjinë e dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, si edhe bashkimi i operatorëve ekonomikë të vlerësuar me pikët maksimale, përfaqësuar nga operatori ekonomik “Alb Shpresa” shpk rezulton se metodologjia e dorëzuar nga ky i fundit është një përshkrim i përgjithshëm, nuk shfaq një përmirësim të termave të referencës së parashikuar nga ana e autoritetit kontraktor, gjithashtu nuk përmban një plan të mirëfilltë të organizimit të kantierit, numrit të kantierëve të cilat do të vihen në dispozicion në krahasim me bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimues, të cilët kanë deklaruar se do të vënë në dispozicion 2 kantiere, një prej të cilëve në KM 1 të objektit ndërkohë një tjetër në KM 56.8 të objektit.

Gjithashtu, referuar dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar se në komponentin e tretë të vlerësimit (cilësia/metodologjia), vlerësimi do të mbështet duke u bazuar edhe në elementët e organizimit të sitit, sigurisë, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit. Në lidhje me planin për sigurimin e cilësisë, KPP konstaton se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë përfaqësuar nga operatori ekonomik “Alb Shpresa” shpk është dorëzuar një përshkrim i shkurtër narrativ se çfarë do të përmbajë plani, por një plan i detajuar se si do të ndiqet.

Sa më sipër analizuar, KPP vlerëson se në respekt të nenit 31 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, metodologjia e propozuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alb Shpresa” shpk nuk përmbush elementët minimale të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në drejtim të grafikut të propozuar të punimeve, organizimit të kantierit ndërkohë referuar edhe me sa më sipër arsyetuar, në tërësi metodologjia e propozuar shfaq një përshkrim të përgjithshëm dhe e pa detajuar në përputhje me objektin e kontratës së procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe si e tillë ajo duhet vlerësuar me një vlerësim ndjeshëm më të ulët se sa ajo e operatorit ekonomik ankimues, gjithashtu edhe metodologjia e propozuar nga ana e operatorit tjetër ekonomik “Jubica” duhet vlerësuar me pikë më pak se sa ajo e bashkimit të

operatorit ekonomik ankimues i cili, ka propozuar një kohëzgjatje të më shkurtër të realizimit të punimeve, parë në rrafsh krahasimor me atë të operatorit ekonomik “Jubica” shpk.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.1.6. Ndërsa në lidhje me komponentin e dytë Pervoja në punë e kompanisë- Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punët e realizuar në formë CV, shoqëruar me vertetim punimesh, të kryera në 10 viteve të fundit, bashkimi i operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini-1” sh.p.k për të cilin është vlerësuar me 20 pikë të mundshme ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë :

- CV e Kompanisë në të cilën përshkruan eksperiencat lidhur me përvojën e ngjashme si vijon:

“Drini-1” sh.p.k

- Kontrata me vlerë 49.827.600 leke me objekt Mirëmbajtje rutinë e dimërore Rruga Lac- Vau i Dejes Fushë Arrëz Viti 2016, shoqëruar me fatura tatimore, Formular vlerësimi lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër, vlera e realizuar 61.8947.788 lekë me objekt Mirëmbajtje rutinë e dimërore Rruga Lac- Vau i Dejes Fushë Arrëz
- Kontrata lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkodër me vlerë 3.332.250 lekë me objekt Pastrim Bore dhe inerte nga rruga (emergjencë) viti 2011
- Kontratë datë 21.02.2011 lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkodër me vlerë 79.342.3960 lekë me objekt Mirëmbajtje rutinë e dimërore Q. Mali –Fierzë, Kohëzgjatja 3 vjet
- Kontrata lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkodër me vlerë 33.337.247 lekë me objekt Mirëmbajtje rutinë e Dimërore Rruga Q. Lac-Koman 32.4 km viti 2014
- Kontrata lidhur me Drejtoria Rajonale Veriore Shkodër me vlerë 26.897.695 lekë me objekt Rehabilitim i shembjeve në segmentin Lac-Vau-Dejës-Fushë Arrës (emergjencë) viti 2016

Shtesë kontrate Kontrate “AEK Munella” sh.p.k.& “Drini-1” sh.p.k. & “Ekskluziv” sh.p.k. vlera e realizuar 19.313.683 lekë me objekt Mirëmbajtje rutinë Rruga e Matit – Rrëshen Urakë Shpal-Reps viti 2017, bashkëlidhur : Fatura tatimore, formular vlerësimi

“AEK Munella” sh.p.k. 30%

“Drini-1” sh.p.k. 36%

“Ekskluziv” sh.p.k. 34%

Kontrate “AEK Munella” sh.p.k.& “Drini-1” sh.p.k. & “Ekskluziv” sh.p.k. me vlerë 96.568.419 lekë me objekt Mirëmbajtje rutinë Rruga e Matit –Rrëshen Urakë Shpal-Ura e Repsit 46 km viti 2015, bashkëlidhur : Fatura tatimore, formular vlerësimi

“AEK Munella” sh.p.k. 30%

“Drini-1” sh.p.k. 36%

“Ekskluziv” sh.p.k. 34%

“AEK Munella” sh.p.k.

- Kontrata nr. 9175 prot datë 11.05.2017 lidhur me Bashkia Mirditë me vlerë 97.376.600 lekë me objekt Sistemim asfaltim Klos-Gjakëz-Domgjon(NJ.A. Fan) Faza I, viti 2017, Formular Vlerëimi AEK Munella” sh.p.k. 44%, fusha sghpk 56%., fatura tatimore.
- Amendim Kontrate me vlerë 19422.600 lekë me objekt Sistemim asfaltim Rruga Klos-Gjakëz-Domgjon(NJ.A. Fan) Faza I, viti 2018
- Kontrata me vlerë 19.422.600 lekë me objekt Sistemim asfaltim Rruga Klos-Gjakëz-Domgjon(NJ.A. Fan) Faza I, viti 2015
- Kontrata me vlerë 30.635.222 lekë me objekt Mirëmbatje rutinë e Rrugës së Kombit, Segmentit rrugor, Degëzohet me autostradën Thumanë –Milot, Hyrja e Tunelit Thierre 73.15 km (emergjencë) Viti 2016.
- Formular vlerësimi me vlerë 43.178.67, me objekt Mirëmbatje rutinë dhe dimërore rruga Rrëshen-Qafë Bene 28 km viti 2011
- Kontratë me vlerë 11.505.100 lekë, me objekt Superstradë-Balldre-Kukel-Rranxa, 18.5km viti 2013
- Kontratë me vlerë 27.315.600 lekë me objekt Mirëmbatje rutine e dimërore rruga Milot Skurraj –Rrëshen 23.6 km viti 2013.
- Kontratë me vlerë 8.297.100 lekë me objekt Mirëmbatje rutinë e dimërore segmenti rrugor Degëzimi i autostradës Thumanë-Milot, fundi i superstradës 26.7 km(emergjencë) viti 2015
- Formular vlerësimi me vlerë 42.327.329 lekë me objekt Mirëmbajtje me performancë kontrata nr. 3 km gjithësi 87.5 km viti 2013, J.V. “AEK Munella” sh.p.k. & “Kthella” sh.p.k. 51%, 49%.
- Formular vlerësimi me vlerë 8.012.678 lekë me objekt Mirëmbatje rutinë e dimërore e segmentit rrugor K/Dajt-Bizë-Q/Priskë-Shëngjergj (76 km).
- Kontrata me vlerë 47.175.810 lekë me objekt Mirëmbatje rutinë e Rrugës së Kombit, Segmentit rrugor, Degëzohet me autostradën Thumanë –Milot, Hyrja e Tunelit Thierre 73.15 km (emergjencë) Viti 2016.

Ndërkohë parë në rrafsh krahasimor me operatorët e tjerë pjesmarrës për të cilët BOE ankimues ka ngritur pretendime në lidhje me mosplotësimin si duhet të këtij komponenti KPP morri në shqyrtim dokumentacionin e dorzuar nga BOE ALB SHPERSA& MELA sh.p.k dhe Jubica shpk si më poshtë:

JUBICA SHPK

1. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Kukës U.Zapoti, Kukës Bushtricë ...me vlerë 135,618,580 lekë me tvsh.
2. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Përmirësimi, rifreskimi i seinjalistikës vertikale, horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore në akset e Rajonit verior Loti 1 me vlerë 167,999,825 lekë me tvsh.
3. Kontratë nr.380/6 datë 16.11.2018 me objekt Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore rruga Koplik Bogë Dedaj Razëm, me vlerë 65,000,000 lekë pa tvsh.
4. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Përmirësim i sigurisë dhe sinjalistikës rrugore në superstadën Tiranë Durrës dhe segmentin rrugor Kashar Rinas Loti 1 me vlerë 394,541,442 lekë me tvsh, Kontrata Shtese me vlerë 57,248,040 lekë.
5. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore rruga Kukës Ura Zapod 15 km, me vlerë 3,727,500 lekë pa tvsh.
6. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje bazuar në performancën Fushë Krujë, Ura e Drojes ... me vlerë 92,499,194 lekë me tvsh.
7. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim adfaltim rruga Hamidiye Shtoj i Vjetër me vlerë 18,341.572 lekë me tvsh.
8. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Përmirësimi rifreskimi i sinjalistikës vertikale horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore Loti 2 me vlerë 581,187,609 lekë me tvsh.
9. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Përmirësimi , rifreskimi, i sinjalistikës vertikale horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore në akset e rajonit verior Loti 1, me vlerë 245,997,116 lekë me tvsh.
10. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë aksi rrugor Qafë Mali Fierzë 58 km me vlerë 133,953,434 lekë me tvsh.
11. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sinjalistika e objektit furnizim dhe vendosje te barrierrave mbrojtëse Sinjalistikë vertikale horizontale dhe Fuga Ure me vlerë 1,124,260 euro.
12. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë rruga Ura e Bahcellëkut Mabe Lezhë 33.7 km me vlerë 31,175,400 lekë.
13. Formular vlerësimi për objektin e kontratës Punime për sistemimin e drenazhmit qëndror përfshi sistemin e tubacioneve veshjen e kanaleve kulluese me beton, punime të tjera ndihmëse të rrugës përfshi gërmimet anësore dhe makinieri, me vlerë 769,555 euro.
14. Kontratë nr.252/5 datë 01.11.20218 me objekt Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë rruga Q.Lac Koman.. me vlerë 49,330,000 lekë pa tvsh.

Alb Shpresa&Mela shpk

- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruktion i rrugës Gërmenj Okshun Zambishte me vlerë 82,799,701 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësim për objektin Rikonstruktion i rrugës Lalëz Bizë Drac me vlerë 150,000,000 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë segmented rrugore Shote Galica ... me vlerë 99,853,455 lekë .
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim i shesheve të pallateve nr.1,2,3,4 me vlerë 18,932,943 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rehabilitim i kanalit të uzinës Kukës me vlerë 29,520,000 lekë.
- Formulatat Vlerësimi për objektin e kontratës Shërbim për mirëmbajtjen e ndërtesave të UPT me vlerë 5,280,000 lekë me tvsh.
- Formulatat Vlerësimi për objektin e kontratës Punime dhe ndërtimi i sheshi parkimit tek Diga e Liqenit me vlerë 12,800,000 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim të rrugëve të brendshme të fshatit Katund i Ri, Komuna Bradashesh me vlerë 74,820,232 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Ndërtimi I shkollës 9 vjecare Vile me vlerë 11,356,984 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Riveshje pjesore e segmentit Maqellarë Peshkopi , loti II, me vlerë 49,799,616 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim i rrugëve të fshatrave Borakë dhe Koxhas me vlerë 60,608,417 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruktion i Zyrave postare të filialit Fier me vlerë 2,400,000 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruktion i zyrave postare të filialit Vlorë me vlerë 3,957,664 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruktion i zyrave postare të filialit Kukës dhe Mat me vlerë 8,765,898 lekë .
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruktion i zyrave postare të filialit Berat, Lushnjë, Sarandë me vlerë 2,477,495 lekë.

- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i zyrave postare të filialit tiranë me vlerë 6,798,197 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i zyrave postare të filialit Shkodër me vlerë 6,095,348 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i zyrave postare të filialit Korçë me vlerë 9,120,000 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Investim në rrjetin elektrik Agjencia Kavajë Zona Sefereaj Kryeluzaj me vlerë 44,119,045 lekë .
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Ndërtim kabina të reja 10/6 kv me rrjet TU të tipit ABC me vlerë 41,866,801 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i godinës me emrtimin Atelier për dekorin e Radio Televizionit me vlerë 95,576,873 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Ndërtim Rruuga Kardhiq Delvinë me vlerë 596,659,3030+82,666.435 kontrata shitesë . Alb Shpresa 15%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim Asfaltim rruga Katund I Vjetër me vlerë 31,955,535 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje me bazë me performance të segmenteve rrugore në Qarkun e Kukësit me vlerë 228,670,187 lekë . Alb Shpresa 70%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i rrugës Domje Ura e Lapajve Kukës me vlerë 333,857,243 lekë. Alb Shpresa 45%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i rrugës Ura e Lapajve Bushtricë Kukës me vlerë 305,517,608 lekë. Alb Shpresa 65%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i rrugës Shëngjin Kune me vlerë 339,474,230. Alb Shpresa 40%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Ndërtim Ura Mat me vlerë 209,132,071 lekë. Alb Shpresa 51%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore segmenti rrugor kr Kolsh me vlerë 38,450,620 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore rruga Bajram Curi Valbonë 27 km .
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë Rruuga Ura e Drojes Lac Patok 26.15 km me vlerë 26, 514,060 lekë.

XHAST

1. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Ndërtimi i palestrës shkollës 9 vjecare ndërtim palestres Kote me vlerë 52,803,674 lekë pa tvsh.
2. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Ndërtim i shkollës së re 9 vjecare Lrumë Has me vlerë 169,275,128 lekë.
3. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rehabilitim i kanalit ujitës Petë Vlorë me vlerë 21,834,588 lekë.
4. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Riparim i argjinaturës së Daragjatit Shkodër me vlerë 23,823,840 lekë.
5. Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim Asfaltim rruga Komisariati Ujësjellës Krujë me vlerë 19,548,780 lekë.

CV Xhast

Bashkia Tirane me objekt: Rikonstruksion Rruga Sadik Petrela 1.Punime ne rruge me vlerë 1.032.788 lekë, viti 2018.

Bashkia Tirane me objekt: Rikualifikim Urban i hapsirave perballe Maternitetit te ri 1.Rikualifikim Urban 1.055.673 lekë, viti 2008-2010.

Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve me objekt: Nderim By Pass Kukes Loti 2 1.Nderim Rruge 45.000.000 lekë, viti 2008-2009

Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve me object: Nderim Rruga Kalimash – Kukes Loti 2 1.Nderim Rruge 62.000.000 lekë, viti 2007-2009

Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve me Nderim Rruga Milot Skuraj Loti 1 1.Nderim Rruge 75.000.000 lekë, viti 2007-2010.

Bashkia Tirane me objekt Rikostruksion i Bllokut 51 Rikostruksion Blloku Banimi me vlerë 5.000.000 lekë, viti 2008-2010

Bashkia Tirane me objekt: Sistemim Asfaltim Rrugesh Njesia 2.9.11 Sitemim Asfaltim Rrugesh me vlerë 1.000.000 lekë,

Bashkia Tirane me objekt Rikualifikim Urban pergjate Rrugesh Lord Bajron Rikualifikim Urban me vlerë 2.000.000 lekë, viti 2009-2011.

Bashkia Tirane me objekt: Projekti Transportit Multimodal Sinjalistike Rrugore me vlerë 1.000.000 lekë, viti 2009-2010

Bashkia Tirane me object: Rikualifikim Urban i Bllokut Mine Peza Rikualifikim Urban me vlerë 790.000 lekë, viti 2011.

Bashkia Tirane me objekt: Ralizim sherbimi mirmbajtje sinjalistike rrugore Vizim rrugore me vlerë 1.310.000 lekë viti 2011

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT me objekt: NDERTIM BY PAS FUSHE KRUJE PUNIME RRUGORE, me vlerë 11.500.000 lekë, viti 2011-2012

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT me objekt: NDERTIM RRUGA BAKS-RRJOLLE PUNIME RRUGORE me vlerë 16.000.000 lekë, viti 2011-2012

BASHKIA KRUME me objekt: NDERTIM SHKOLLA 9- VJECARE KRUME NDERTIM SHKOLLE E RE me vlerë 3.000.000 lekë, viti 2011-2012

Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve me objekt: Sistemim Asfaltim Rruga e Gjinarit Ndretime Rruge me vlerë 52.000.000 lekë, viti 2009-2013

Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve me objekt Sistemim Asfaltim Rruga e Shishtavecit Ndretime Rruge me vlerë 2.432.000 lekë, viti 2010-2013

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR me objekt: NDERTIM BY PASS SHKODER LOTI 1 NDERTIM RRUGE E RE, me vlerë 14.000.000 lekë, viti 2011-2017

BASHKIA KAVAJE me objekt: RIKONSTRUKSION BASHKIA KAVAJE RIKONSTRUKSION me vlerë 400.000 lekë, viti 2012-2013

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT me objekt: NDERTIM RRUGA NACIONALE-IBALLE LOTI 1 NDERTIM RRUGE me vlerë 98.000.000 lekë, 2013 -2015

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT me objekt: NDERTIM RRUGA NACIONALE-IBALLE LOTI 2 NDERTIM RRUGE me vlerë 38.000.000 lekë, viti 2014 -2015

BASHKIA TIRANE me objekt: RIKONSTRUKSION RRUGA DIBRES RIKONSTRUKSION RRUGE me vlerë 1.300.000 lekë, viti 2013

Bashkia Durres me objekt: Ndretime Shkolla Mesme Ish Keneta Durres Ndretime Shkolle e Re me vlerë 5.000.000 lekë, viti 2011-2013

BASHKIA DURRES +PIU me objekt NDERTIM BANESA SOCIALE DURRES NDERTIM BANESA SOCIALE Sek.II me vlerë 7.000.000 lekë, viti 2012 – 2015

Bashkia Kavaje me objekt Rikonstrukcion Sheshi Kavaje Rikualifikim sheshi me vlerë 9.000.000 lekë viti 2014 -2015

PIU + BASHKIA DURRES me objekt: NDERTIM BANESA SOCIALE DURRES NDERTIM BANESA SOCIALE Sek.III me vlerë 4.000.000 lekë viti 2015

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT me objekt: Rikualifikimi sheshi qendror Kukes Rikualifikim sheshi me vlerë 3.000.000 lekë, viti 2015-2016

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT me objekt: "Rehabilitimi i rrugës Transballkanike Fazat 1 dhe 2 Rikualifikim dhe ndricim me vlerë 2.000.000 lekë, viti 2016

OSHEE GJIROKASTER me object “ Projekt i Rrjetit te ri kabllor me izolacion 20 kv, Fideri F-3 dhe Fideri F-4, Nenstacioni 110/20 kv, Gjirokaster”. Punime rrjeti elektrik me vlerë 2,956,395 lekë, viti 2015

Fondi Shqiptar i Zhvillimit me object: Ndertim Rruga Vlore – By Pass Peshkepi – Gjorm Ndertim Rruge me vlerë 98.000.000 lekë, viti 2017 –vazhdim

Fondi Shqiptar i Zhvillimit me object: Ndertim rruga PortPylli Sodes Vlore Ndertim rruge me vlerë 3.000.000 lekë viti 2017-2018

Bashkia Vlore me object: Ndertim Ura e Zvernecit Vlore Ndertim Ure me vlerë 6.000.000 lekë , viti 2017

Fondi Shqiptar i Zhvillimit me object: Ndertim Rruga Harku berdices – Velipoje Loti 2 Rikonstruksion Rruge me vlerë 16.111.946 lekë, viti 2017-2018

AUTORITETI RRUGOR me object: MIREMBAJTJE RRUGE KUKES
MIREMBAJTJE RRUGE me vlerë 10,657,246 lekë, viti 2019

BASHKIA TIRANE me object: RIKOSTRUK UJSJELLSI
RIKOSTRUKSION I PLOTE me vlerë 37,484,477 lekë viti 2019.

BASHKIA TIRANE me object: RIKOSTRUK RRUGE FORTUZI
RIKOSTRUKSION I PLOTE me vlerë 58,264,326 lekë viti 2019.

AUTORITETI RRUGOR me objekt: MIREMBAJTJE RRUGE DURRE
MIREMBAJTJE RRUGE me vlerë 14,245,100 lekë viti 2019

BASHKIA TIRANE me object: RIKOSTRUK RRUGE P.VIDI
RIKOSTRUKSION I PLOTE me vlerë 126,000,000 lekë, viti 2019.

BASHKIA TIRANE me object: RIKOSTRUK RRUGE KASALLE
RIKOSTRUKSION I PLOTE me vlerë 36,255,724 lekë viti 2019

III.1.9. KPP vlen të sqarojë se ka një dallim të qartë midis kriterëve të vecanta për kualifikim në drejtim të dëshmisë së eksperiencës së ngjashme gjatë tre viteteve të fundit të hartuar në përputhje me nenin 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 28 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, dhe kriterit të përcaktimit të ofertës fituese. Në rastin konkret, KPP gjen me vënd të sqarojë se nga ana e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës së prokurimit, janë vlerësuar nga ana e autoritetit kontraktor se disponojnë eksperiencë të ngjashme, për rrjedhojë vlerësimi i kapacitetit teknik me pikë në fazën e dytë do të mbështet në një vlerësim të qëndrueshmërisë së eksperiencës teknike në 10 vitet e fundit në kontrata të ngjashme, dëshmisë së operatorët ekonomikë disponojnë eksperiencë dhe aftësi teknike për realizimin me sukses të kontratës, parë kjo gjithashtu edhe në rrafsh krahasimor me operatorin tjetër ekonomik.

Referuar sa më sipër, Komisioni gjykon se procesi i pikëzimit është bërë në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit. Fryma e LPP është e tillë që çdo

operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore është plotësuar në maksimumin e mundshëm nga operatori ekonomik AEK Munella shpk e rrjedhimisht është vlerësuar nga autoriteti kontraktor me 20 pikë të mundshme. Ndërkohë sa i takon operatorit ekonomik Jubica shpk KPP vlerëson se edhe ky operator shfaq një eksperiencë të thelluar në fushën e mirëmbajtjes së akseve rrugore në përputhje me objektin e prokurimit duke paraqitur eksperiencë gati të njëjtë në këtë procedurë prokurimi e për këtë arsye është vlerësuar nga autoriteti kontraktor me 18 pikë nga 20 pikë të mundshme.

Ndërsa sa i takon ofertuesit tjetër BOE Alb Shpresa shpk& Mela shpk&Xhast shpk KPP gjykon se edhe për këtë bashkim operatorësh vlerësimi është bërë në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk mund të thuhet se shfaq një eksperiencë të gjatë e të thelluar në fushën e mirëmbajtjes e për këtë arsye është vlerësuar nga autoriteti kontraktor me 14 pikë nga 20 pikë të mundshme.

Në këtë kuptim KPP gjykon se pikëzimi për operatorët ekonomikë Jubica shpk dhe BOE Alb Shpresa shpk& Mela shpk&Xhast shpk lidhur komponentin përvojë e ngjashme nuk do të ndryshojë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “AEK Munella” shpk nuk qëndron

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “AEK Munella” sh.p.k.& “Drini-1” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-65268-07-13-2020, me objekt Loti V “*Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Rëshen (U.Fanit)-Shpal, Shpal-Q. Bene-K.Hadroj, Shpal-Ura e Repsit*”, me fond limit 219.866.693 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar”.
2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktues brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “AEK Munella” sh.p.k.& “Drini-1” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Nr.1404 Protokolli, Datë 03.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri